



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.05.10.2023]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT1
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

OPERATORIT EKONOMIK “NET- GROUP” SHPK

ADRESA: TIRANE RRUGA HAXHI DALLIU, HYRJA 1, APARTAMENTI 0

Procedura e prokurimit/lotit: **“Shërbim konsulence”**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-71601-06-05-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **”Tarraca të Sistemuara, Interaktive, Multifunksionale dhe pjesërisht të gjelbëruara”.**

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i kontrates*): Buletini Nr. 53 datë 12 Qershor 2023

Publikimet e mëparshme (*Njoftimi paraprak i fituesit*): Buletini Nr. 82 datë 2 Tetor 2023

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

- **Operatori ekonomik “NET- GROUP” shpk me NUIS L72023002P**
- **BOE “Adriatica RC” shpk & “Engineering Consulting Group” shpk me NUIS M01506035F & M01308013C**

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar ofertuesi me vlerat përkatëse të ofruara:

- **Operatori ekonomik “NET- GROUP” SHPK me NUIS L72023002P**

Vlera e ofertës pa tvsh = **13.600.000 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind mijë) lekë** dhe totali i pikëve të marra **98.3 (nëntëdhjetë e tetë pikë tre) pike.**

- **BOE "ADRIATICA RC" SHPK & ENGINEERING CONSULTING GROUP" SHPK me NUIS M01506035F & M01308013C**

Vlera e ofertës pa tvsh = **14.900.000 (katërbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) lekë** dhe totali i pikëve të marra **87.7 (tetëdhjetë e shtatë pikë shtatë) pike.**

Lista e operatorëve ekonomikë të s’kualifikuar:

1. BOE “ARKIMADE” shpk & “SPHAERA” shpk me NUIS L01906030A & NUIS J81809003U

S’kualifikuar në fazën e parë për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të ofertave pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar në dt 31.07.2023 me anë të shkresës Nr.27567 prot pranë Bashkisë Tiranë nga **BOE “ARKIMADE” shpk & “SPHAERA” shpk** konstaton se përmban mangësitë si më poshtë vijon:

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 6, të VKM Nr 285 dt 19.05.222021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) parashikohet se: *“..Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Nisur nga sa më sipër, BOE “Arkimate” shpk & “Sphaera” shpk me anë të shkresës hyrëse me Nr 27567 prot dt 31.07.2023 ka depozituar pranë Bashkisë Tiranë dokumentacionin provues dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga ana e BOE “Arkimate” shpk & “Sphaera” shpk si edhe pas riverifikimit të bërë në sistemin e prokurimit elektronik të dokumentacionit të depozituar në ditën e hapjes së ofertave ka konstatuar se bashkimi i operatorëve ekonomikë si më sipër cituar **nuk kane paraqitur Bilancin për vitin 2022** duke rënë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shtojcën e dt 15.06.2023 “Për një ndryshim dhe saktësim në DST për procedurën e prokurimit me objekt: ”Tarraca të Sistemuara, Interaktive, Multifunksionale dhe pjesërisht të gjelbëruara” dhe konkretisht me përcaktimin e bere ne nën-piken 2.2.2 të pikës 2.2 të rubrikës “Kapaciteti ekonomik edhe financiar” të kësaj shtojce ku është cilësuar si më poshtë:

“Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020,2021,2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit

dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

Për sa më sipër, referuar edhe rekomandimeve të APP-së si edhe dispozitave ligjore të sipërcituara çdo operator ekonomik përpara shpalljes fitues duhet të paraqesë për shqyrtim edhe vlerësim dokumentacionin në formë të shkruar pranë Autoritetit Kontraktor. Ndërkohë që Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit apo çdo dokumenti tjetër bashkëlidhur DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 26/6 dhe Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe konkretisht në shtojcën e dt. 15.06.2023 bashkëlidhur setit të këtyre dokumentave.

2. Operatori ekonomik “PAT Power Automation & Teknology” shpk me NUIS L41723018R

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Neni 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori Ekonomik “**PAT Power Automation & Teknology**” shpk, ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, vetëm ofertë ekonomike përkatësisht me vlerë zero, të pashoqëruar me dokumentacionin e duhur ligjor dhe teknik. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dokumentacion ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

3. Operatori ekonomik “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” shpk me NUIS K71606006A

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

Operatori ekonomik “**INSTITUTI DEKLIADA - ALB**” shpk ka paraqitur sigurimin e ofertës me Nr. serial 230604187 të lëshuar nga Shoqëria e sigurimit “Albsig” sha e cila ka afat vlefshmërie 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë ndërkohë që në dokumentat standarte të tenderit (DST) është kërkuar 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë.

Referuar nenit 30 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) cilësohet se:

“ *Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit². Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe”.*

Duke qënë se periudha e vlefshmërisë së paraqitur në sigurimin e ofertës nga ana juaj është 150 ditë pra në një kohë më të shkurtër se ajo e parashikuar në dokumentat standarte të tenderit oferta juaj do të refuzohet.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për fazën e dytë nuk ka operatorë ekonomik të s’kualifikuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik “NET-GROUP” SHPK**, me adresë: Tirane Rruga Haxhi Dalliu, Hyrja 1, Apartamenti 0, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **13.600.000 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind mijë) lekë** pa tvsh/ totali i pikëve të marra **98.3 (nëntëdhjetë e tetë pikë tre) pike** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **14.900.000 (katërbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) lekë/** totali i pikëve të marra **87.7 (tetëdhjetë e shtatë pikë shtatë) pike**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____